


814-1  
M 76

Tonin Miloti



**Parada e gaforreve**

FABULA

8JH-1  

---

M 76

Tonin Miloti

Parada  
e gaforreve

---

FABULA



SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHERI»

Handwritten text at the top right corner, possibly a date or page number.

Tonin Miloj

*Redaktor*  
**DIONIS BUBANI**

*Piktor*  
**BARDHYL FICO**

Parada  
e gatoreve

FABULA



*Reçensues:*  
**Dilaver Dilaveri**  
**Razi Brahimi**

SHKURTË E LIBRIT  
DILAVER DILAVERI  
RAZI BRAHIMI

## KAPEDANI

— Pra, unë jam syri

që shikoj brigje e lëndina të gjelbëruara,  
qiej e dete, male me kurorë,  
hënën kur lundron mes yjesh të pambaruara,  
qengjat që harbojnë  
e fluturat krahëlëshuara.

— Por shushuritjen e fletëve të blirit,  
fyej e zamare e bilbila,  
qoftë rrufetë kur nis rrebeshi  
apo erën e ëmbël të zefirit,  
unë i dëgjoj, — ndërhyri veshi.

— Vërtet, — u përgjegj këmba, — or miq,  
po kush ju shpie në ato lëndina,  
në pyje e ujëvara të kristalta,  
atje ku bora vesh bjeshkët e larta?  
Ç'do të bënit ju pa mua, pa më thoni,  
se larg rritet sherebelja nga limoni...

— Po qe për limona e portokalle,  
për erëza që dalin në kopshtije,  
për vjollca, karafila e lulemali,  
veç unë, — tha hunda, — u njoh rrënjë e shije.  
Pa mua dhe bërsitë, në pisk të diellit,  
do kishin sy e faqe për t'u matë  
me erën që jep gonxh' e trëndafililit.

— Pushoni, — u tha goja, — o të marrë,  
o mburacakë, kapadai, fodullë,  
me botën rreth e rrotull lidhem unë  
e në kuvende mbaj vendin e parë,  
e flas, bërtas, këndoj e jap vendime  
që dredhin edhe lisat qindvjeçarë.

Mendja që kish dëgjuar, qetë e qetë,  
thirri trurin si një nënë e mirë.

— Pa dil e shih se ç'është kjo mynxyrë,  
se fjala fjalën nxjerr dhe nxehet gjaku,  
t'i vesh në vend ti shqisa e gjymtyrë,  
tregohu se këtu ka zot konaku.


Çdonjëra syresh kryen punë të vyer,  
çdonjëra si ushtarët në detyrë  
por ti je Kapedani, more bir!



## PARADA E GAFORREVE

Në rërë, plisa e shkurre  
gjëmuar bori e tambure  
e sheshi i juntës fashiste harbonte  
se midis këtij rëmeti  
kryegaforrja kremtonte  
përvjetorin e grushtit të shtetit.  
Fjalimi qe furtunë,  
ku çdo frazë shoqërohej  
me drithma e shkumë!  
«Kuadrate të çelikta,  
ju gaforre të idhëta,  
nga gjeneralët me dekorata


te tetaret këmbëshkathta;  
ju që dolët nga errësira e detit,  
ju që erdhët nga zgavrat,  
nga çufra e rëra e thatë,  
jeni radhitur sot  
për marrshimin e gjatë  
drejt fitoreve  
për lavdinë e gaforreve.  
Përpara, pra, me ritmin krenar  
nën ujë, mbi tokë e nëpër bar!  
E mos u stepni  
nga llafe e intriga,  
nga sytë ziliqarë  
e gojët e liga,  
që thonë se ne ecim së prapi.  
Shkurt hesapi,  
ne kemi mënyrën tonë të lëvizjes,  
kemi këtë lloj hapi  
qysh nga stërgjyshi ynë i vjetër,  
kokën para e këmbët n'anën tjetër,  
dhe bota, po desh,  
le të ecë sipas nesh.»  
Gaforre, përpara,  
përpara me hapa,  
më falni, desha të them,  
gaforre përprapa, —  
marrsh!



## DY VENDIME

Për punë shembullore  
në prodhimin e vezëve  
pë kuzhina dhe oborre,  
për sakrifica deri në heroizëm,  
insektet e dekoruan mizën  
me medaljen — flori  
anti — Di-Di-Ti —





Të nesërmen paradite  
Gardalinën e laboratorit  
antiinsekticide  
e doktor Trumcakun  
e qendrës sanitare,  
mbledhja plenare  
e zogjve, që erdhën truma-truma,  
i pushoi nga puna.

## ARA DHE KANAĪLI

Parcela e rreshkur për ujë  
po digjej si furrë;  
ndërkohë në qiell  
lundronte një re,  
mbuluar nga veli i hollë.

— Pak ujë, pak ujë,  
mikesha ime,  
se ta shpërblej  
me bimë e gjelbërime...

Reja, si grua lozonjare,  
kaloi tutje maleve  
pa e vështruar fare.

— Ah, re mizore,  
thirri ara e zvetënuar;  
më duket se erdhi ora  
që të vdes nga etja